



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.21 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, më.....miraton:

RREGULLORE NR. __/2025
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES Nr.03/2023 PËR SHITESA
DHE KOMPENSIME PËR TË PUNËSUARIT NË SISTEMIN PROKURORIAL

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.03/2023 për shtesa dhe kompensimet për të punësuarit në sistemin prokurorial.

Neni 2

Neni 5, paragrafi 4 i rregullores bazike te kompensimi për punën në kujdestari është në vlerë 20%, para përqindjes i shtohet teksti “ **deri në** ”

Nenit 5 të rregullores bazike i shtohet edhe paragrafi 5:

5. Këshilli varësisht prej buxhetit në dispozicion e rregullon me vendim të veçantë.

Neni 3

Neni 16 i rregullores bazike te kompensimi për shpenzimet e përfaqësimit ristrukturohet si në vijim:

Paragrafit 1 i shtohen pikat 1.10, 1.11 dhe 1.12:

1.10 Anëtarët e KPK-së;

1.11 Zëvendëskryeprokurorët;

1.12 Udhëheqësi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve.

Paragrafi 6 ristrukturohet si në vijim:

Pika 6.6 Kryeprokurori i PSRK-së dhe 6.7 Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ndryshon vlera nga **120€ deri në 150€**.

Pika 3.11 ndryshohet në 6.11 dhe pika 3.12 bëhet 6.12, të cilës i ndryshohet vlera nga 20€ deri në 50€.

Paragrafit 6 i shtohet pika 6.13, 6.14 dhe 6.15:

6.13 Anëtarët e KPK-së, shuma deri në 80€;

6.14 Zëvendëskryeprokurorët, shuma deri në 50€;

6.15 Udhëheqësi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve, shuma deri në 50€.

Neni 3

Nenit 18 të rregullores bazike i riformulohet emërtimi: **E drejta në kompensim për funksion shtesë.**

Paragrafit 1 i fshihet pika 4, **1.4 Prokurori i autorizuar si përgjegjës për njësinë ndërlidhëse.**

Neni 4

Nenit 19 të rregullores bazike i fshihet paragrafi 2, ndërsa paragrafi 3 riformulohet si në vijim:

2. Anëtari joprokuror i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, i cili e ka të pezulluar detyrën e punës prej nga vjen, kompensohet me pagën ekuivalente të anëtarit prokuror të KPK-së me orar të plotë.

2.1. Anëtari joprokuror i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, i cili nuk e ka të pezulluar punën prej nga vjen, pranon diferencën e shtesës/kompensimit nga paga bazë e tij dhe pagës së anëtarit prokuror të KPK-së, me orar jo të plotë, të nivelit themelor të Departamentit të Krimeve të Rënda.

Nenit 19 i shtohet paragrafi 7:

7. Anëtarët e KPK-së me orar të plotë nuk kanë të drejtë në asnjë kompensim tjetër shtesë.

Neni 5

Nenit 25 të rregullores bazike te shtesa për vëllimin e punës i shtohet paragrafi 5:

5. Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, me vendim të veçantë, kur e vlerëson të nevojshme dhe kur ka buxhet, mund t'i kompensojë edhe sekretarët, të cilët i ofrojnë mbështetje trupave të përhershme të KPK-së.

Neni 6

Nenit 34 i rregullores bazike te kompensimi për shpenzimet e përfaqësimit i shtohet paragrafi 4:

4. Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së ka të drejtë që sipas nevojës zyrtare të tejkalojë kufizimet e përcaktuara në paragrafin 3 pika 3.1 të këtij neni.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më _____ 2025

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës